



Dalës-Izlazna

Nr. 1-54
Br.

Data 08.04.2019
Datum

OBILIÇ-OBILIÇ



Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosova
Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obilic

Në mbështetje të nenit 52 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, dhe nenit 61 të Statutit të Komunës së Obiliqit, caktoj:

Mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa me dt. 16.04.2019, (e martë) në ora 10:00 në sallën e Kuvendit komunal me këtë:

R E N D D I T E

1. Arsyetimi për mungesë
2. Aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Shqyrtimi i kërkesës së Kryetarit të Komunës, për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës
4. Formimi i Komisioneve, sipas vendimit të Qeverisë nr.07/96, të dt.02.4.2019 (Plotësimi dhe Ndryshimi i Komisioneve)
5. Shqyrtimi i kërkesave
6. Të ndryshme



Kryesuesi i Komitetit

Burim Gërguri
Burim Gërguri



Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosova
Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obilic

EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

Nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, të mbajtur me dt.26.3.2019, në orën 10:00, në sallën e Kuvendit komunal.

Të pranishëm janë këta anëtarë: Burim Gërguri, Florije Jashari, Linda Sadiku, Fatmir Bekteshi, Hysni Mjeku, Qëndresa Dubova, dhe Slavisa Spasic

Të pranishmit tjerë: Ibush Mjekiqi, Nënkryetar i Komunës, Zarife Behluli, drejtoreshë e DEFZH, Agim Spahiu, drejtor i DKA-së, përf. i KFOR-it, përf. i USAID-it

Mbledhjen e udhëhoqi Burim Gërguri, kryesues i cili pasi konstatoi se ka kuorum filloi mbledhjen me këtë:

REND DITE

1. Arsyetimi për mungesë
2. Aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Shqyrtimi i propozimit të Kryetarit të Komunës, nismën për bashkëpunim ndër komunal/at (Komunës së Prishtinës, Komunës së Podujevës dhe Komunës së Vushtrisë) në fushën e infrastrukturës fizike
4. Shqyrtimi i planit të punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2019
5. Shqyrtimi i raporteve përfundimtare të Komisionit vlerësues për dhënien e pronës komunal në shfrytëzim :
 - a) Raporti me nr V-188 , datë:22.02.2019
 - b) Raporti me nr V-187 , date :22.02.2019
6. Shqyrtimi i kërkesës së DSHPE-së
7. Shqyrtimi i kërkesës së MAPL-së (rishikimi i vendimit nr. 203 dt.28.12.2018)
8. Shqyrtimi i kërkesave
9. Të ndryshme

Burim Gërguri – I njoftoi të pranishmit me rendin e ditës.

Aprovohet njëzërit rendi i ditës, i cekur më lartë.

1.Pika e parë e rendit të ditës –

Të gjithë anëtarët e Komitetit ishin të pranishëm.

2.Pika e dytë e rendit të ditës –

Aprovohet njëzërit ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e kaluar pa vërejtje.

3.Pika e tretë e rendit të ditës

Burim Gërguri – Paraqet propozimin e Kryetarit të Komunës, nismën për bashkëpunim ndërkomunal (Komunës së Prishtinës, Komunës së Podujevës dhe Komunës së Vushtrisë) në fushën e infrastrukturës fizike.

Fatmir Bekteshi – Pyeti se Komuna e Prishtinës a e ka nënshkruar këtë marrëveshje.

Burim Gërguri – Përgjegjet se në këtë fazë marrëveshja nuk është nënshkruar, për shkak se është afati i fundit 12 ose 14 prill për aplikim në Ministri, por brenda këtij muaji të gjitha Komunitatet i aprovojnë nismat e Kryetarëve për bashkëpunim ndërkomunal. Në këtë fazë Komunitatet lidere ose parësore, që aplikojnë është Komunitati e Obiliqit, si partner i përbashkët me 3 Komunitatet tjera.

Fatmir Bektashi – Pyeti nëse, nuk gjejmë mbështetje në Ministrinë përkatëse, çfarë do të bëhet me rrugën Breznicë-Koaricë, a do të renovohet.

Burim Gërguri – Përgjegjet se nëse, nuk gjejmë mbështetje ju e dini se ne kemi ndarë mjete dhe kemi buxhet për këtë vit. Gjithsesi aksi rrugor Breznicë-Koaricë, do të renovohet, ndriçohet dhe do të bëhet ndërtimi i trotuarit. Unë besoj se Ministria e infrastrukturës dhe ajo e pushtetit lokal do të hasin në mirëkuptim dhe Komunitatet ka marrë obligim kur është aprovuar buxheti se ai aks do të renovohet.

Pas diskutimeve, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, unanimisht morën këtë:

REKOMANDIM

I rekomandohet Kuvendit Komunal për shqyrtim dhe aprovim propozimi i Kryetarit të Komunitatit, nismën për bashkëpunim ndërkomunal/at (Komunitatet së Prishtinës, Komunitatet së Podujevës dhe Komunitatet së Vushtrrisë) në fushën e infrastrukturës fizike.

Pika e katërt e rendit të ditës –

Burim Gërguri – Paraqet planin e punës të Kryetarit të Komunitatit për vitin 2019.

Pas diskutimeve, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, unanimisht morën këtë:

REKOMANDIM

I rekomandohet Kuvendit Komunal për shqyrtim Plani i Punës i Kryetarit të Komunitatit për vitin 2019.

Pika e pestë e rendit të ditës

Burim Gërguri – Paraqet raportin nr.V-188, të dt.22.02.2019 të Komisionit vlerësues për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim.

Pas diskutimeve, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, unanimisht morën këtë:

REKOMANDIM

I rekomandohet Kuvendit Komunal për shqyrtim dhe aprovim raporti përfundimtar i Komisionit vlerësues për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim me nr.V-188, dt.22.02.2019.

Burim Gërguri – Paraqet Raportin nr.V-187, i dt.22.02.2019, të Komisionit vlerësues për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim. Nga Komisioni vlerësues është refuzuar oferta e ofertuesit “Shtëpia e shpresës” për Shtëpinë e kulturës në Milloshevë, sepse nuk i plotëson kriteret e parapara sipas shpalljes publike.

Pika e gjashtë e rendit të ditës

Burim Gërguri – Paraqet kërkesën e DSHPE-së, për vendosjen e një trafoje në Plemetin. Unë kërkoj nga drejtori i DPUKP, që në mbledhjen e Kuvendit, të na sqaroj realisht pronën në mënyrë që vendimi i Kuvendit të jetë i qartë.

Pas diskutimeve, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, unanimisht morën këtë:

REKOMANDIM

I rekomandohet Kuvendit Komunal për shqyrtim dhe aprovim kërkesa e DSHPE-së me nr.VI-205, e dt.12.03.2019.

Pika e shtatë e rendit të ditës

Burim Gërguri – Paraqet kërkesën e MAPL-së, (rishikimi i vendimit nr.203, i dt.28.12.2018). Kërkesa ka qenë nga DPUKP-ja, për lirim nga pagesa për rastet sociale me rastin e ndërtimit të shtëpive nga donatorët. Ne kemi nxjerrë një vendim për këtë çështje, por meqë MAPL-ja, po kërkon atëherë këtë vendim duhet ta shfuqizojmë.

Arben Berisha – Ju njoftoj se ne në padijeni, por i kemi parapri një kërkesë të qytetarëve, që e kemi konsideruar shumë të arsyeshme për me i lirue nga pagesa rastet sociale sidomos në ndërtimin e shtëpive nga donatorët. Mirëpo, Udhëzimi administrativ i fundit që ka dalë jepë mundësinë, që me shkue pa pagesë të gjitha lejet ndërtimore për rastet sociale. Prandaj, bën mos me marrë vendim tjetër të ri.

Burim Gërguri – Sqaron se ky vendim në mbledhjen e radhës duhet të shfuqizohet për shkak të pjesës ligjore dhe obligohemi ligjërisht me i kthye përgjegje MAPL-së, për aktin që e kemi marrë.

Pas diskutimeve, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, unanimisht morën këtë:

REKOMANDIM

I rekomandohet Kuvendit Komunal shqyrtimi dhe aprovimi i kërkesës së MAPL-së, (rishikimi i vendimit nr.203, i dt.28.12.2018)

Pika e tetë e rendit të ditës

Burim Gërguri – Paraqet kërkesën e DKA-së, lidhur me Draft Rregulloren për ndarjen e bursave, kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit dhe aktiviteteve jashtëshkollore.

Pas diskutimeve, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, unanimisht morën këtë:

REKOMANDIM

I rekomandohet Kuvendit Komunal për shqyrtim dhe aprovim kërkesa e DKA-së, për Draft Rregulloren për ndarjen e bursave, kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit dhe aktiviteteve jashtëshkollore.

Burim Gërguri – Paraqet kërkesën nga Besnik Kastrati, për shëndrrimin e tokës bujqësore në atë ndërtimore.

Pas diskutimeve, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, unanimisht morën këtë:

REKOMANDIM

I rekomandohet Kuvendit Komunal për shqyrtim kërkesa nr.I-4011, e dt.10.2.2019.

Burim Gërguri – Paraqet kërkesën nga Shoqata sindikale e administratës komunale, për ndihmë financiare.

Pas diskutimeve, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, unanimisht morën këtë:

REKOMANDIM

I rekomandohet Kuvendit Komunal dhe Këshillit të drejtorëve për shqyrtim dhe aprovim kërkesa nr.I-8592, e dt.21.3.2019, nga Shoqata sindikale e administratës komunale për ndihmë financiare.

Burim Gërguri – Paraqet kërkesën nga Qendra rinore, në Obiliq për përkrahje të projektit “Avokim tek institucionet publike e private për të rekrutuar të rinjtë për punë vullnetare brenda institucioneve lokale”.

Pas diskutimeve, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, unanimisht morën këtë:

REKOMANDIM

I rekomandohet Kuvendit Komunal dhe Këshillit të drejtorëve kërkesa nr.I-8469, e dt.21.3.2019 nga Qendra Rinore, për realizim të projekteve.

Burim Gërguri – Paraqet kërkesën e OVL të UÇK-së, që mjetet e ndara nga Kuvendi komunal për vitin 2019, të bëhen në llogari të qendrës së OVL-së, të UÇK-së.

Pas diskutimeve, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, unanimisht morën këtë:

REKOMANDIM

I rekomandohet Ekzekutivit të Komunës, shqyrtimi i kërkesës nr.I-5706, e dt.27.02.2019, e OVL-së, UÇK.

Burim Gërguri – Paraqet kërkesën nga Labinot Rrukolli dhe Rustem Rukolli, për shëndrrimin e tokës bujqësore në atë ndërtimore, në Milloshevë.

Pas diskutimeve, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, unanimisht morën këtë:

REKOMANDIM

I rekomandohet Ekzekutivit të Komunës për shqyrtim kërkesa nr.I-7872, e dt.15.3.2019. Kjo kërkesë mbetet të trajtohet në muajin prill.

Arben Berisha – Ju informoj se ne planin zhvillimor e kemi tenderue dhe mendojmë që përmes planit zhvillimor të japim një kahje të mirë dhe të plotësojmë këtë zbrastësi në mënyrë që në ardhmen të mos kemi kërkesa të tilla.

Burim Gërguri – Uroj të jetë kështu dhe të ndahen zonat sepse ai plan prapë duhet të votohet në Kuvend. Realisht ne jemi në një gjendje jo të mirë sepse duam ta zhvillojmë biznesin, por kemi pengesa ligjore, prandaj duhet të përgatiten hartat zonale.

Pika e nëntë e rendit të ditës

Arben Berisha – Një kërkesë e juaja që më ka ardhë prej Kuvendit, për ndërrim të parcelës në fshatin Llazarevë dhe unë ua kam kthyer një përgjegje përmes emailit me dt.22.mars.

Burim Gërguri – Lidhur me këtë kërkesë që po e thoni ju, do të shohë më vonë.

Tani, dua ta ngriti një shqetësim se në mbledhjet që i kemi pasë për buxhet dhe planifikim në këtë vit, mbi 19 takime bashkë me Kryetarin e Komunës, në fshatin Plemetin ishte një kërkesë që të stopohet ndërtimi i shtëpive të reja për ata që vijnë nga Komunitat tjerë. Kërkoj që ZKKK-ja, në mbledhjen e prillit të na sjellë një raport për 3 vitet e fundit lidhur me numrin e romëve të kthyer dhe shtëpitë e ndërtuara nga Ministria për kthim dhe komunitete, në mënyrë që të dijmë saktë se cilët banorë kanë qenë përfitues të atyre shtëpive.

Arben Berisha – Sa i përket kësaj teme, ne si Drejtori i kemi bërë shkresë Kryetarit dhe organeve kompetente që mos të nënshkruhen marrëveshje për ndërtim pa pasë në plan zhvillimor lejen e ndërtimit. Neve, na kanë ardhë prej Ministrisë 5 ndërtime, donacione që janë dhënë, por 3 prej tyre nuk mund të pajisen me leje dhe aty s'mund të ndërtohet. Është mirë të kemi një përkrahje prej Kuvendit, për ata që nuk i plotësojnë kriteret, ne s'mund të japim leje. Njerëzit më heret kanë ndërtuar në parcelë të pandarë, është komplet lagje dhe kanë krijuar probleme të mëdha dhe tash nuk dijmë se çka të bëjmë.

Burim Gërguri - Nëse, nuk gaboju është një vendim i Kuvendit komunal në vitin 2014, që kthimi i qytetarëve të bëhet, por për banorët e Komunave tjerë, të bëhet një zgjidhje për shkak të mbingarkesës që ka ndodhë.

Mbledhja përfundoi në ora 11:00

Bashk. prof. për punë të KK-së



Azize Zeneli



Kryesuesi i KPF-së



Burim Gërguri